

**VENDIM**  
**NR.3, DATË 20.11.2014**  
**I ORTAKUT TË VETËM**  
**TË SHOQËRISË "VERINA" SH.P.K**  
**KLOS BURREL**

Sot me datë 20/11/2014 në selinë e Shoqërisë "VERINA" SH.P.K KLOS BURREL u zhvillua mbledhja e ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË, rendi i ditës të së cilës është, shqyrtimi i raportit të paraqitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar për rritjen e Kapitalit të shoqërisë nëpërmjet përfshirjes në capital të "Rezervave të tjera" dhe "Fitimit neto të vitit 2013" që janë gjendje sipas Bilancit Kontabël më datë 31.12.2013 dhe në përfundim ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "VERINA" SH.P.K KLOS BURREL,

**VENDOSI:**

- Miratimin e raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar z.Bujar RAMI
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të shoqërisë sipas mënyrës së përcaktuar në raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar.
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të shoqërisë "VERINA" SH.P.K KLOS BURREL nga 8.433.000 lekë, në 26.621.000 lekë.
- Nr i kuotave do të pakësohet me 8432 kuota,pra nga 8433që ishin do të ngelet vetem 1(një)kuotë .
- Vlera nominale e një kuote të vetme do të rritet me një vlerë 26.620.000 lekë ,pra do të bëhet 26.621.000. lekë,nga 1.000 lekë që ishte.
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Q.K.R –së Tiranë.
- Ngarkohet Znj Evisa RAMI të ndjekë procedurat ligjore për depozitimin e këtij vendimi pranë QKR-së .

**ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATOR**

(Vebi Mellani)

**VENDIM**  
**NR.2, DATË 6.11.2014**  
**I ORTAKUT TË VETËM**  
**TË SHOQËRISË "VERINA" SH.P.K**  
**KLOS BURREL**

Sot me datë 6/11/2014 në Selinë e Shoqërisë "VERINA" SH.P.K KLOS BURREL u zhvillua mbledhja e ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË ,për emërimin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për hartimin e raportit të zmadhit të kapitalit nëpërmjet "Rezervave të tjera" dhe "Fitimit neto të vitit 2013",që janë gjendje sipas bilancit kontabël me datë 31.12.2013, dhe në përfundim :

**VENDOSI:**

- Caktimin e z. Bujar RAMI , anëtarë i I.E.K.A , me profesion Ekspert Kontabël i Regjistruar ,me licensë Nr. 90. datë 10.01.2001, për vlerësimin e zmadhimit të Kapitalit Aksionar nëpërmjet "Rezervave të tjera" dhe "Fitimit Neto te vitit 2013" që janë gjendje sipas Bilancit Kontabël më datë 31.12.2013.
- Depozitimin e këtij vendimi në Q.K.R
- Ngarkohet Znj. Evisa RAMI, të ndjekë procedurat ligjore për depozitimin e këtij vendimi pranë QKR –së.

**ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATOR**

(Vebi Mellani)